**VENDIM**
**Nr. 144, datë 22.2.2012**

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE "PËR KRIJIMIN E INFRASTRUKTURËS KOMBËTARE TË TË DHËNAVE GJEOHAPËSINORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të politikave "Për krijimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore", sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, ministritë e linjës e institucionet përgjegjëse për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**